

Prishtinë: 15/06/2006  
**ERO/CPD\_D\_03\_06\_06**

**Nga:** Departamenti për Mbrojtje të Konsumatorëve

**Për:** Z. Shyqri Dumani, adresa: Dardani 10 000 Prishtinë, Kosovë

**Lënda:** Përgjigje në Kërkesën me Nr 6/5 të datës 26.05.2006

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17.1 të Ligjit për Rregullatorit e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Përgjigjen e KEK-ut, Nr Referimi DPR – 6847 me datë 10.05.2006;
4. Ankesën e bërë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) të Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas nenit 14.1 të Rregullës mbi procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të regjistruar me 26.05.2006; me numer regjistrimi 6/5 2006;
5. Në përputhshmëri me Nenin 14.3 të Rregullës mbi procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve me datë 06.06.2006 ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit dhe bazuar në faktet e paraqitura dhe në bazë të kompetencave të dhëna sipas Nenit 14.3 të Rregullës mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve; Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve merr këtë:

### **VENDIM**

Kërkesa e Konsumatorit Z. Shyqri Dumani nga Prishtina **ËSHTË REFUZUAR** për arsye të paraqitura në Arsyetimin e këtij vendimi.

### **Arsyetim**

Konsumatori në ankesën e tij të drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të ZRRE-së të datës 26.05.2006 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut të datës 10.05.2006, e cila përgjigje i është dhënë në lidhje me kërkesën e konsumatorit drejtuar KEK-ut për ta liruar nga pagesa dhe borgji i taksës për Radio Televisionin e Kosovës (RTK).

KEK-u në Përgjigjen e dhënë konsumatorit ka theksuar bazën ligjore të aplikueshme në Kosovë rreth pagesës së RTK “Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2003/12” sipas së cilës konsumatori në fjalë nuk e gëzon të drejtën e lirimit nga pagesa e taksës për RTK, dhe e ka njohtuar konsumatorin për të drejtën e tij për tu ankuar në Zyren e Rregullatorit për Energji.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve duke vlerësuar ankesën e konsumatorit drejtuar ZRRE-së, përgjigjen e KEK-u dhënë konsumatorit dhe duke u bazuar në Kornizën Ligjore të Aplikueshme në Kosovë, konstaton se përgjigja e KEK-ut dhënë Konsumatorit është në pajtim me legjislacionin në fuqi, andaj refuzon ankesën e konsumatorit si të pabazë, për arsye se:

1. Në bazë të **Ligjit Nr. 02/L-47** për Radiotelevizionin e Kosovës duke u thirrur në nenin 20.4 të këtij Ligji të gjitha subjektet fizike dhe juridike në territorin e Kosovës janë të obliguar të paguajnë parapagimin për transmetuesin publik. Si një subjekt i tillë do të konsiderohen njesitë të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike
2. Të liruar nga kjo pagesë sipas nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 janë ato vendbanime ose pjesët e vendbanimeve të Kosovës në të cilat mungon sinjali cilësor televiziv i rrjetit tokësor, dhe Familjet që janë përfshirë në listën e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale si kategori e veçant përfshirë edhe ato që janë nën asistencë sociale.
3. Pasi që ju nuk i plotësoni kushtet e nenit 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr.02/L-47 kërkesa e juaj refuzohet

**DEPARTAMENTI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE**  
**ERO/CPD\_D\_03\_06\_06, dt 15.06.2006**

**Kryesuesi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve**  
Azem Kastrati



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kunder këtij vendimi Konsumatori mund të ankohet në Bordin e ZRRE-së në afat prej katërmbdhjetë (14) ditëve kalendarikë nga dita e marrjes së të njejtit nga konsumatori apo nga dita e shpalljes në faqen elektronike të ZRRE-së, cila do që ndodhë më parë.